

Mevledin Mustafi, PhD¹

UDC:
342.22-049.6:[32:34

**SIGURIA NË KUPTIMIN POLITIK DHE JURIDIK – MASAT DHE
MBROJTJA NGA AKTIVITETET QË CENOJNË PAVARËSINË
DHE INTEGRITETIN E SHTETIT**

**БЕЗБЕДНОСТА ВО ПОЛИТИЧКА И ПРАВНА СМИСЛА -
МЕРКИ И ЗАШТИТА ОД АКТИВНОСТИ КОИ ГО
ЗАГРОЗУВААТ НЕЗАВИСНОСТА И ИНТЕГРИТЕТОТ НА
ДРЖАВАТА**

**SECURITY IN POLITICAL AND LEGAL SENSE - MEASURES
AND PROTECTION FROM ACTIVITIES THAT ENDANGERING
THE INDEPENDENCE AND INTEGRITY OF THE STATE**

Abstract

To be able to talk about state security, it is necessary to know what the state is and what are the security risks that threaten it. In this sense, when it comes to security risks, It will be about the biggest threat and this is aggression. The state is the basic and most important form of organization of every class society. The state is that territory with its inhabitants, which the ruler holds under his rule as a property of his own. In most other languages also in Albanian the name for the state comes from Latin status from the context status rei Romanae. Such is

¹ University professor, with a long experience in the Ministry of Internal Affairs of the Republic of Macedonia.

the root of the French word *etat*, Italian *stato*, English *state*, Spanish *estado*, German *staat* ect.

It's characteristic that these terms that express the clear distinction of state organization from feudal property or society in the wider sense of the word appear relatively late: only from the beginning of the 16th century. The clear distinction of the meaning of the state coincides with the period of formation of modern state organizations in the form of absolute monarchies. Throughout a long history of theoretical development and philosophical-scientific thinking about society and politics, many efforts have been made to explain and understand the origin and nature of the state.

Key words: Security, society, state organization, security in the political and legal sense, measures, defense activities, endangering independence, integrity, country, endangering integrity and independence etc.

Ai që disponon informatën dhe informacionin e ka edhe sigurinë edhe shtetin.

1. Siguria në kuptimin më të gjerë politiko-juridik

Gjatë formulimit të problemit të hulumtimit është e domosdoshme të bëhet distinkcion i politikës së sigurisë nga nocionet e tjera të përafërta koncept, strategji, plan, doktrinë dhe ngjashëm, përkatësisht të bëhet një sqarim për dallimet terminologjike dhe për ato esenciale ndërmjet politikës së sigurisë dhe nocioneve të tjera. Politika e sigurisë ka pozitë më të lartë në raport me dokumentet e tjerë strategjikë me të cilët rregullohet siguria e shtetit, nga aspekti i asaj që politika e sigurisë është dokument i integruar strategjik në të cilin janë përfshirë më shumë tema të sigurisë të cilat janë objekt i bashkëpunimit integruar kombëtar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të komunitetit më të gjerë të sigurisë. Siguria në kuptimin më të gjerë politik-juridik përfshin masat dhe aktivitetet e mbrojtjes nga rrezikimi i pavarësisë dhe integritetit të një vendi *shteti, kombi* dhe të rendit të brendshëm kushtetues dhe ligjor.

Që të mund të flitet për sigurinë shtetërore, është e nevojshme të dimë se çka është shteti dhe cilat janë rreziqet e sigurisë që asaj i kërcënohen. Në këtë kuptim, kur është puna te rreziqet e sigurisë, do të bëhet fjalë për kërcënimin më të madh, e ky është agresioni. Shteti është forma bazë dhe më e rëndësishme e organizimit të çdo shoqëria klasore. Shteti është ai territor me banorët e saj, të cilën sundimtari e mban nën sundimin e vet si një pronë të tij. Në shumicën e gjuhëve të tjera edhe në shqip emërtimi për shtetin vjen nga latinishtja *status* nga konteksti *status rei Romanae*². E tillë është rrënja e fjalës frënge *etat*, italiane *stato*, angleze *state*, spanjolle *estado*, gjermane *Staat* etj. Është karakteristike se këto terma që shprehin dallimin e qartë të organizimit shtetëror nga prona feudale apo të shoqërisë në kuptim më të gjerë të fjalës paraqiten relativisht vonë: vetëm nga fillimi i shekullit XVI-të. Ndarja e qartë e kuptimit të shtetit kohësisht përputhet me periudhën e formimit të organizimeve shtetërore moderne në formën e monarkive absolute. Përgjatë një historie të gjatë të zhvillimit teorik dhe të mendimi filozofik-shkencor për shoqërinë dhe politikën, janë bërë shumë përpjekje të shpjegohet dhe të kuptohet origjina dhe natyra e shtetit.³ Dallimet terminologjike mbi shtetin dhe kuptimin e tij, sikur edhe disa mangësitë teorike mbi shtetin, kur bëhet fjalë për historinë e këtij institucioni, nxjerrin në shesh dobësi evidente në studimin e teorisë së shtetit. Pa marrë parasysh dallimet e përmendura, janë bërë përpjekje që të kuptohet dhe të shpjegohet prejardhja e shtetit. Kanë ekzistuar dhe ekzistojnë shumë teori, të cilat shtetin e shikojnë si shtrirje kuantitative të organizimit fillestar të familjes dhe të fisit; teoritë për origjinën qiellore të pushtetit shtetëror, të cilat veçmas kanë qenë të përhapura në mesjetë; teoritë objektive-idealiste të cilat te shteti shohin sendërtimin e frymës dhe idesë absolute, të shpirtit të popullit dhe njerëzimit, vlerat më të larta morale, teoritë biologjiko-organike e shohin dhe e shpjegojnë shtetin si organizëm të rendit më të lartë, organet e të cilit kanë funksionin dhe marrëdhëniet të ngjashme me organet e njeriut dhe të qenieve të tjera të gjalla, teoritë e marrëveshjes shoqërore, të cilat kanë lulëzuar në shekujt XVII-të dhe XVIII-të si kritikë teorike feudale për origjinën qiellore të shtetit.

² Bashkim Dr. Selmani “E drejta romake dhe ndikimi saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”, f.123-124 Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2014.

³ Gjendja e sigurisë paraqet fenomen kompleks, i cili jep pasqyrë të vëllimit dhe intensitetit të më shumë elementeve të kërcënimit të sigurisë kombëtare rreziqe, kërcënime dhe sfida.

2. Termi Shtet përdoret në disa kuptime

Termi shtet përdoret me kuptime të ndryshme. Në kuptimin e ngushtë, me nocionin shtet nënkuptohet vetë aparati shtetëror, organizimi hierarkik i përbërë prej bartësve individualë dhe kolektivë të pushtetit shtetëror dhe nga të gjithë nëpunësit dhe zyrtarët që hyjnë në përbërje të organeve të ndryshme të tij.⁴ Në këtë kuptim, shteti është kundërvënie drejtpërdrejtë shoqërisë mbi të cilën ushtrohet ky pushtet. Por shteti është edhe subjekti themelor i marrëdhënieve ndërkombëtare. Me gjithë që vepron si forcë e jashtme e shoqërisë dhe qëndron mbi të, ai në fund të fundit është vetëm formë e konstituimit të një shoqërie klasore, i pandarë prej saj. Duke marrë parasysh këtë, për shtetin mund të flitet edhe në kuptim më të gjerë. Në një rast të këtillë, me shtet nënkuptojmë shoqërinë e tërë të përfshirë në një organizim shtetëror, pra jo vetëm aparatit shtetëror, por edhe territorin dhe banorët që janë nën pushtetin e shtetit. Shteti është edhe fenomen historik. Ai lind kur zhvillimi i forcave prodhuese të shoqërisë rrënon përfundimisht strukturën homogjene shoqërore të bashkësive të para primitive.⁵



Fig. nr. 1. Elementet përbërëse të shtetit

⁴ Një shtet që zvogëlon subjektet e tij, duke i bërë instrumente të bindura të projekteve të tij, ai nuk mund të bëj gjëra të mëdha. (John Stuart Mill).

⁵ Zhvillimi i forcave prodhuese është mbështetur mbi ndarjen e punës e cila gjithashtu, nga ana e saj, ka pasur rëndësi të madhe për zhvillimin e forcave prodhuese dhe për ndryshime afatgjata në strukturën e shoqërisë dhe të organizimit të saj të përgjithshëm. Nga këmbimi sporadik zhvillohen format e përhershme të lidhjeve ndërmjet punëve të ndryshme të fiset e ndryshme, kurse më vonë gjithnjë e më shumë edhe ndërmjet familjeve me lidhje të gjakat.

Territori shtetëror është hapësira në të cilën shtrihet pushteti i një shteti të caktuar dhe i cili është i shënjuar me kufirin shtetëror. Hapësira mbi dhe nën territorin shtetëror gjithashtu i takon po atij shteti, që d.m.th. se territori shtetëror nuk është vetëm sipërfaqe e tokës, por është tredimensionale. Territori i shtetit përfshin edhe një brez të sipërfaqes detare nga kufiri në drejtim të detit të hapur, e ky brez quhet ujëra territoriale. Gjerësia e ujërave territoriale sot nuk është e përcaktuar në mënyrë unike dhe shtrihet nga tri deri në dymbëdhjetë milja detare. Sovranitet bregdetar i shtetit shtrihet edhe në ujërat territoriale, me përjashtim se ky sovranitet ka disa kufizime, siç janë detyrimi për të lejuar kalimin e lirë të anijeve etj. Territori mandatar është nën pushtetin, *mandatin* e ndonjë shteti tjetër. Për ekzistimin e vete, shteti duhet të ketë disa elemente themelore, të cilat konsiderohen si attribute fundamentale, e këto janë: territori, popullsia, pushteti dhe karakteristikat e sovranitetit. Territorin e shtetit e përbën një hapësirë që e bën shtetin si bashkësi të njerëzve të ndryshme nga subjektet tjera, sidomos në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky element paraqet edhe divergjencën fundamentale ndërmjet krijesave të shumta mesjetare dhe shteteve bashkëkohore.

Elementin e dyte te shtetit, popullsinë, e përbëjnë njerëzit që janë banorë të përhershëm në hapësirën e shtetit. Pa popullsi nuk ka organizim të shoqërisë njerëzore. Pra, bëhet fjalë për ndikim shumë të rëndësishëm të popullsisë në veprimtarinë e përgjithshme organizative e funksionale shtetërore. Popullsia është faktor relevant politik, kur bëhet fjalë për veprimtarinë politike të shtetit dhe për proceset politike që zhvillohen në shoqëri, prandaj ajo konsiderohet si element kyç për formësimin dhe ndërtimin e organeve të veprimtarisë shtetërore. Numri i banorëve merret si masë kuantitative, ndërsa veçoritë individuale të banorëve dhe orientimet zhvillimore konsiderohen ndër treguesit themelore të fuqisë së shtetit. Por, edhe këtu ka dallime. Në vetitë kualitative të popullsisë bëjnë pjesë mosha e popullsisë, shkalla e arsimimit, rritja demografike dhe vendosja e popullsisë, vetitë fizike, raporti midis popullsisë së vjetër dhe popullsisë së re, mentaliteti dhe karakteri i popullsisë, etj. Rëndësi e madhe i kushtohet edhe strukturës nacionale të popullsisë, kështu që mund të flitet për shtete me strukturë homogjene nacionale dhe me strukturë shumë nacionale. Disa autorë i dallojnë shtetet edhe si oazë „përkatësisë klasore“.

Termi sovranitet rrjedh prej fjalës neolatine *superanus*, *supremus* më i larti, *suprem* dhe prej fjalës frënge *sovrain*, e cila kuptim të njëjtë

terminologjik. Mendimi politik ka filluar të merret me këtë problem qysh prej kohëve më të lashta, e sidomos me lindjen e shtetit. Elementet e para të teorisë mbi sovranitetin i hasim në mileniumin e tretë para Erës së Re, në Egjiptin e vjetër, në tërësinë e mësimëve mbi piramidën sociale. Gjatë trajtimit të sovranitetit, është nisur nga fakti se sovraniteti është pushteti më i lartë, më i pakufizuar, më absolut, më i qëndrueshëm, më i patjetërsueshëm, cili e ka të drejtën e nxjerrjes së ligjeve, të emërimit të zyrtarëve më të lartë shtetërorë, të vendosjes mbi luftën dhe paqen, të faljes, të tatimit dhe të bindjes. Pra, bëhet fjalë për sovranitetin si „pushtet më i lartë, i cili nuk njeh asnjë pushtet tjetër më të lartë se veten“.⁶ Përveç elementeve themelore të përmendura, të cilat janë të domosdoshme që të mund të flitet për organizimin politik të shoqërisë, mund të përmendim dhe ekonominë nacionale, kulturën nacionale si dhe organizatat tjera që ekzistojnë në një shtet. Qytetarët e pranojnë shtetin si autoritet të bashkësisë, si pushtet legjitim e ligjor, si pushtet që duhet të kujdeset për respektimin e të drejtave të njeriut. Është rregull që për një njohje të tillë mjafton pajtueshmëria e shtetit fqinj në drejtim të të cilit shtrihet kufiri, e është bërë zakon që kufijtë të përcaktohen me marrëveshjen ndërmjet shteteve fqinje.⁷

Në çdo sistem të organizmit shtetëror ekziston dallimi ndërmjet organeve politike dhe atyre shtetërore tekniko-profesionale. Organet politike janë bartës të pavarur të disa prerogativave të pushtetit shtetëror. Ato marrin vendime politike, d.m.th. përcaktojnë orientimet dhe përmbajtjet e politikave shtetërore. Organet profesionale dhe ndihmëse administrative ushtrojnë pushtetin shtetëror vetëm në bazë të autorizimeve që tek ato i bartin organet politike. Ato janë instrumente të zbatimit të një politike të caktuar. Dallimi ndërmjet organeve politike dhe profesionale-administrative, ndërmjet organeve që vendosin politikisht dhe aparatit administrative që zbaton vendimet e marra, merr kuptim të

⁶ Teorinë e parë më të plotë mbi sovranitetin e përfaqëson mendimtari politik francez Zhan Boden Jean Boden 1530-1596, në librin e tij 6 vëllimor mbi Republikën Les six livres de la République. I udhëhequr nga shkaqet politike, Bodeni.

⁷ Shih po ashtu: F. H. Hinsley, Power and Pursuit of Peace. Cambridge University Press, Cambridge, 1963, f. 20-29; Walter Schiffer, The Legal Community of the Mandkind: A Critical Analysis of the Modern World Organization. Columbia University Press, New York, 1954, f. 3, etj.; Inis L. Claude Jr., Swords në Plowshares. The Problems and Progress of International Organization. Random House, New York, 1956, f. 44, etj.; Hueng-Soon Park, Collective Security and International Order: The Role of the United Nations in the Korean 1950 and the Persian Gulf War 1990. University of South Carolina, 1993, f. 18, etj.

veçantë në organizimin demokratik të sistemit shtetëror, me ç'rast organet politike janë në përputhje me organet e zgjedhura përfaqësuese.⁸ Nga marrëdhëniet e vendosura në praktikë ndërmjet organeve politike dhe aparatit shtetëror, nga pavarësia më e madhe ose me e vogël e burokracisë shtetërore varet së tepërmi shkalla e demokratizimit të rregullimit shoqëror.⁹

3. Shkallët e rrezikshmërisë për një shtet

Agresioni-Shkalla më e lartë e rrezikut për një shtet është agresioni. Çka është agresioni dhe kush mund të jenë agresorët? Marrë në përgjithësi agresioni është sulm, shkelje, çdo formë e dhunës. Në rastin tonë agresioni është sulm i paprovokuar i një ose më shumë shteteve mbi sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit tjetër, me qëllim të pushtimit territorial ose të ndërrimit të dhunshëm të rregullimit të brendshëm, ose për të arritur qëllime të tjera politike dhe plane të ngjashme, me të cilat rrezikohet pavarësia dhe sovraniteti ose tërësia territoriale e vendit të sulmuar.¹⁰ Më së shpeshti është sulm i armatosur dhe bëhet me përdorimin e forcës ushtarake, por përfshin edhe çdo aksion të drejtuar kundër tërësisë territoriale dhe pavarësisë së shtetit tjetër, sikundër edhe paqes në botë.¹¹

Agresori-Agresor është shteti i cili në çfarëdo mënyre rrezikon pavarësinë, sovranitetin ose integritetin territorial të shtetit tjetër, respektivisht forcat e armatosura të të cilit sulmojnë një vend tjetër. Karta e OKB-së i jep të drejtë shtetit të sulmuar dhe bashkësisë ndërkombëtare që kundër agresorit të përdorë mjetet individuale dhe kolektive të vetëmbrojtjes dhe sipas të drejtës ndërkombëtare çdo shtet mund t'i kundërvihet me të gjitha mjetet dhe format e luftës që ka në dispozicion, por që nuk janë të ndaluara me të drejtën ndërkombëtare.

⁸ Përveç mendimeve teorike të përmendura mund të theksojmë se teoria tradicionale politike e shtetit është studiuar vetëm si organizim politik, pastaj si botëkuptim instrumentalistik të shtetit ndaj të cilit ai është mjet ose instrument, gjegjësisht aparat institucional i sundimit e ngjashëm.

⁹ Kemi nevojë për liri për të penguar shtetin të abuzoj me pushtetin e tij dhe kemi nevojë për Shtetin për të penguar abuzimin e lirisë-Karl Popper.

¹⁰ Alan Collins "Studime bashkëkohore të sigurisë", f.131.UET/Press, Tiranë,

¹¹ Teorive të përmendura mund t'ua shtojmë edhe teorinë sidaristike, si edhe teorinë elitiste, të cilat e shpjegojnë lindjen dhe funksionet e pushtetit shtetëror, si edhe shumë pikëpamje të tjera, të cilat e problematizojnë lindjen e shtetit dhe përcaktimin kuptimor të tij nga qasje të ndryshme shkencore e teorike.

E drejta ndërkombëtare mbështet mbrojtjen nga agresori duke i ofruar ndihmë edhe atyre qytetarëve të cilët në mënyrë të paorganizuar apo në çfarëdo forme tjetër i kundërvihen forcave të tjera dhe vijnë deri te konflikti apo lufta e hapur. Kur të definohet siguria shtetërore në kuadër të sigurisë kombëtare, nisemi nga fakti që ajo paraqet veprimtari të veçantë të organeve të veçanta dhe të caktuara në planin e mbrojtjes së rendit të caktuar shoqëror dhe politik. Vëllimi dhe kuadri i veprimtarisë më së shpeshti përcaktohet me kushtetutë dhe me ligje, ndërsa objektet e mbrojtjes janë baza mbi të cilat mbështetet rendi i caktuar shtetëror për shembull pronësia mbi mjetet e prodhimit, format e qeverisjes, rendi politik dhe kushtetues, sovraniteti kombëtar, respektivisht mbrojtja e rendit publik në tërësi. Zakonisht bëhet dallimi i sigurisë kombëtare në kuptim të ngushtë dhe në kuptim të gjerë. Me sigurinë kombëtare në kuptim të ngushtë zakonisht nënkuptohet veprimtaria që ka për qëllim të garantojë sigurinë personale dhe pronësore të përcaktuar me kushtetutë dhe ligje. Siguria në kuptim të gjerë përfshin veprimtarinë që ka për qëllim themelor mbrojtjen e bazave mbi të cilat mbështetet një rregullim i caktuar shtetëror.

4. Detyrat kryesore dhe qëllim organeve shtetërore

Nga kjo që del se del se detyrë kryesore dhe qëllim i këtyre organeve shtetërore zbulimi dhe pamundësimi i të gjitha aktiviteteve që janë të drejtuara në drejtim të rrezikimit ose të rrëzimit të dhunshëm të bazave të rendit shoqëror-politik dhe shtetëror. Një mënyrë e këtyre e dallimit të sigurisë buron nga mënyra e realizimit të mbrojtjes edhe të objekteve që merren nën mbrojtje, kështu që në këtë mënyrë theksohet vetëm aspekti funksional i nocionit siguri, ndërsa lihet me një anë fakti se shumë rrezikime të sigurisë personale-pronësore përmbajnë në vete edhe elemente të rrezikimit të bazës përkatëse të rendit shoqëror-politik.¹²Që këndej ndarjet e këtyre kanë vetëm vlerë relative. Punët e sigurisë shtetërore në kuadër të sigurisë kombëtare realizohen kryesisht përmes organeve përkatëse dhe shërbimeve siç janë: policia, shërbimi i zbulimit dhe kundërzbulimit dhe disa organe të tjera të drejtësisë dhe të

¹² Siguri është veprimtaria që konsiston në grumbullimin e të dhënave ose informacionit për veprimtari që cenojnë ose synojnë të cenojnë sigurinë fizike të personelit, të informacionit, të rrjeteve të komunikimit, shkëmbimit, transmetimit të informacionit të klasifikuar *sektet shtetëror*.

prokurorisë. Më tej, me sigurinë shtetërore nënkuptohet përdorimi dhe aplikimi i metodave, masave dhe veprimeve nga organet, shërbimet dhe subjektet politike, me të cilët parandalohet, pamundësohet ose bëhet të parrezikshëm bartësit e veprimtarive që rrezikojnë shtetin. Fundja, me ligje dhe normativa të tjera janë caktuar organet, shërbimet dhe organizatat që janë të obliguara me kohë të zbulojnë, pengojnë ose të bëjnë të parrezikshëm personat ose grupet e organizuara në territorin e vet ose në botën e jashtme, të cilët përpiqen të rrezikojnë rendin publik, d.m.th. sistemin e sigurisë nacionale. Këto aktivitete të organeve përkatëse manifestohen në parandalimin e veprave penale të drejtuara kundër shtetit, zbulimin e përgatitjes së këtyre veprave penale dhe parandalimin e kryerjes së tyre, zbulimin e veprave të kryera penale të kësaj natyre, kapja e kryerësve të tyre dhe dënimi i tyre nga organet e gjyqit. Përveç punës së organeve dhe shërbimeve të përmendura, faktor me rëndësi i sigurisë shtetërore janë masat dhe aktivitetet e organeve të shtetit dhe të sistemit të zbulimit, të cilët me aktivitetin e vet agjitacionin, propagandën dhe informimi, ngushtojnë hapësirën për veprim bartësve të veprimtarive të rrezikshme dhe forcojnë rezistencën e shoqërisë duke ngritur kulturën e sigurisë. Në kuptimin e ngushtë organizativ, me siguri shtetërore nënkuptohen organet të cilat në mënyrë direkte angazhohen në punën e mbrojtjes së sigurisë shtetërore, pra janë shërbimet e sigurisë, shërbimi kundërzbulues dhe shërbimi i sigurisë publike. Përkundër dallimeve në organizimin e këtyre shërbimeve në shtete të caktuara, të cilat janë të kushtëzuara prej rregullimit shtetëror, organizimin e qeverisjes shtetërore, traditës dhe arsyeve tjera, përsëri ekzistojnë edhe ngjashmëri. Në punët e sigurimit shtetëror angazhohen edhe drejtoritë e sigurimit ose shërbimet kundërzbuluese, apo edhe drejtoritë e sigurimit ushtarak në ministritë e forcave të armatosura. Kur është fjala për shtetin si i vetmi subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare, kështu edhe në fushën e sigurisë, vendet e përgjithshme të përmendura janë të integruara Brenda vetë bërthamës së funksionit dhe funksionimit të shtetit.

Forma, cilësia, organizimi dhe qëllimi i sigurisë së secilit shtet varet nga një numër faktorësh. Siguria e një vendi është para së gjithash veprimtari sistematike. Në thelb, kjo është gjendje në të cilën është siguruar mbijetesa e baraspeshuar fizike, shpirtërore, shoqërore dhe materiale e personit dhe bashkësisë shoqërore në raport me individët dhe bashkësitë tjera shoqërore dhe natyrës. Që të arrihet kjo, gjegjësisht që siguria të funksionojë si element imanent strukturor i shoqërisë, është

e domosdoshme që secili shtet të përcaktojë politikën e sigurisë, e cila rrjedh nga gjendja e sigurisë. Gjendja e sigurisë është tërësi e elementeve rrezikuese të cilat ndaras dhe bashkërisht kanë ndikim në gjendjen e sigurisë dhe disponimin e njerëzve në një territor të caktuar, mjedis ose objekt në një kohë të caktuar.¹³ Në paraqitjen e veprimtarisë së kërcënimit të jashtëm dhe të brendshëm, është e nevojshme që të njihen dhe njoftohen forcat, vatrat, objektet e sulmit, metodat dhe format e shprehjes të cilat realizohen nga kërcënuesit, si dhe gjendjet e konfliktit dhe krizës në epokat e caktuara, dhe rrethanat të cilat i shkojnë për shtati armiqve për realizimin e veprimtarisë rrezikuese.

Elementeve të cilët formojnë gjendjen e sigurisë- Në vlerësimin e elementeve të cilët formojnë gjendjen e sigurisë, është e domosdoshme të zbulohen tendencat e qëllimet e bartësve të veprimtarisë kanosëse, veç e veç. Kjo arrihet me krahasimin e shprehjes së rrezikshmërisë në periudhat e mëparshme. Shërbimet e sigurisë ofrojnë elemente për gjendje sigurie shteteve dhe organeve tjera të cilat kryejnë vlerësimin e sigurisë dhe qëllimet që duhen realizuar në situatë të caktuara. Politika e sigurisë, në mënyrë të përgjithshme. *Me këtë kuptojmë:* sigurinë e jashtme, sigurinë e mbrojtjes, sigurinë e jashtme dhe të brendshme ekonomike e financiare, sigurinë e brendshme. Por, kur është fjala për definimin e sigurisë së brendshme, dallohen siguria juridike, siguria publike si substitut i sigurisë personale ose grupe, si dhe siguria sociale. Ndërsa fushat që i përkasin sigurisë, janë ushtarake, politike, ekonomike pronësore, sociologjike dhe ekologjike. E gjithë kjo, në thelb, në thelb rrjedh, në këndvështrimin teorik, nga katër grupe të përgjithshme të vlerave, e ato janë: ekzistenca, integriteti territorial, pavarësia politike dhe cilësia e jetesës.

Me *ekzistencë*, sërish në rrafshin teorik, nënkuptohet *ekzistenca e shtetit, ekzistenca kombëtare dhe vetëmbrojtja fizike*. Shkurt, ekzistenca kuptohet si qëllim logjik dhe tendencë e secilit sistem shoqëror, secilës organizatë politike dhe çdo personi. Kur është fjala për *ekzistencën e shtetit*, synohet që shteti si sistem i pushtetit të organizuar, si subjekt i

¹³ Që këndeje ndarjet e këtylla kanë vetëm vlerë relative. Punët e sigurisë shtetërore në kuadër të sigurisë kombëtare realizohen kryesisht përmes organeve përkatëse dhe shërbimeve siç janë: policia, shërbimi i zbulimit dhe kundërzbulimit dhe disa organe të tjera të drejtësisë dhe të prokurorisë.

pavarur i së drejtës ndërkombëtare, si aktor në marrëdhëniet ndërkombëtare, të mos humbë identitetin dhe mos të bëhet pjesë e një apo më shumë shteteve ose të mos shkatërrohet në shumë shtete të vogla, nga të cilat asnjëri s'do të ishte si ai i deriatëhershmi. Begatimi i vetëdijes së personit, bashkësisë dhe shtresave më të gjera të shoqërisë mbi format, metodat dhe bartësit e veprimtarisë rrezikuese, bëjnë më të aftë që ti kundërvihen konkretisht këtyre veprimtarive. Kuptohet, politika autonome e sigurisë të shteteve të veçanta duhet të ishte edhe në pajtim me Deklaratën e KB, mbi parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit nga 24 Tetori 1970, në të cilën thuhet se:¹⁴ Me këto mbrohen vlerat themelore të çdo shoqërie konkrete dhe me këtë edhe më gjerë, në kuptimin e gjendjes rajonale, kontinentale dhe botërore. Interesat themelore të sigurisë janë pandashmërisht të ndërlidhura me vlerat themelore, ndërsa vlerat themelore janë:

- ✚ mbrojtja e jetës, të drejtave kushtetuese, lirive dhe sigurisë personale të qytetarëve;

- ✚ mbrojtja e pavarësisë dhe integritetit territorial duke u bazuar në barazinë e shteteve dhe popujve;

- ✚ mbrojtja e demokracisë dhe të drejtave njerëzore,

- ✚ mbrojtja e të drejtave njerëzore dhe civile,

- ✚ mbrojtja e të drejtave të popujve, grupeve fetare dhe pakicave kombëtare;

- ✚ mbrojtja e vlerave familjare dhe morale dhe

- ✚ sigurimi i vazhdueshëm i mjedisit jetësor për krijim të mirëqenies materiale dhe

- ✚ përparimit të përgjithshëm;

Mbi këto, gjithsesi bazohen interesat themelore: mbrojtja e sistemit kushtetues; zhvillimi i marrëdhënieve të sigurisë me shtete tjera, duke udhëhequr politikë proaktive të sigurisë; parandalimi i konflikteve; krijimi i sigurisë kooperative dhe ruajtja e paqes botërore; pjesëmarrje strategjike në ekonominë globale; forcimi i pozitës ndërkombëtare dhe qasja në sistemet kolektive të sigurimit dhe mbrojtjes; përfshirje dhe pjesëmarrje aktive në asociacionet rajonale dhe organizatat ndërkombëtare, dhe mbrojtja e ambientit, me parandalim të degradimit ekologjik dhe shfrytëzim racional të resurseve natyrore. Për të pasur një zbatim adekuat dhe të suksesshëm të politikës së e sigurisë, është e domosdoshme që secili shtet të ketë një sistem të ndërtuar dhe efikas të

¹⁴ Alan Collins “Studime bashkëkohore të sigurisë”, f.131.UET/Press, Tiranë.

sigurisë kombëtare shtetërore. Sipas shumicës së autorëve, strukturat e sigurisë, e kështu edhe sistemi i saj, janë specifike për secilin shtet.¹⁵ Megjithatë, një strukturë më konsistente të sistemit të sigurisë kombëtare të një shteti bashkëkohor e ka dhënë Anton Grizold me bashkëpunëtorë, 1999. Sipas Grizoldit, elementet themelore një sistemi të tillë do të ishin:



Me politikë të sigurisë nënkuptohet: politika e jashtme, politika e mbrojtjes, politika ekonomike, politika sociale, politika ekologjike, politika energjetike, politika arsimore dhe politika kulturore. *Struktura e sigurisë* është e përbërë nga elementet strukturore si *politika e jashtme mbrojtëse* forcat e armatosura dhe mbrojtja civile mbrojtja civile, mbrojtja ekonomike, gjegjësisht përgatitja e ekonomisë për kushtet e luftës, masat për veprimin e sistemit politik në kushtet e jashtëzakonshme dhe të luftës, kundërshtimi i paarmatosur ndaj agresionit, veprimtaria informative-komunikative, vëzhgimi dhe zbulimi, *siguria e brendshme* policia, organet gjyqësore, shërbimet informative dhe të sigurisë, shërbimet e inspektimit, dogana. Por më duhet të përkujtoj që përfundimisht ky sistem varet nga shumë faktorë, ndërsa mund të dallohen trashëgimia historike, pozita gjeopolitike parësisht nga aspekti i mjedisit të afërt, pozita gjeostrategjike, zhvillimi ekonomik dhe potencialet kadrovike-materiale, potenciali demografik, rregullimi administrativ, parashikimi i qëllimeve dhe rregullimi shoqëror i shtetit.

¹⁵ Alan Collins “Studime bashkëkohore të sigurisë”, f.151.UET/Press, Tiranë.

Conclusion

In the spirit of higher attitudes, security policy should provide answers to questions of protecting the interests and priorities of citizens, the society and the state in general, from any kind of external and internal threats, and foresee political, economic and military measures in this regard; That policy should be all inclusive in her attitude for rooting out the roots of conflict and instability. This is what we mean continuous analysis of security environment and seeking the way of active and equal cooperation, avoiding conflicts, threats and aspirations in double sided meaning integration, strategic cooperation and partnership, tendencies towards collective security, and others. In implementing security policy, there are several factors. First of all, can be distinguished threat assessment and security risk. It means orientation of attention towards tendencies or possible phenomena in the spheres such as: internal conflicts caused on any ground, violent change of internationally accepted borders, eventual expansion of ethnic or religious extremism, violent changes of constitutionally-regulated regulation, organized crime, proliferation, trafficking of human beings, illegal migration, terrorism, the development and transfer of weapons of mass destruction, social problems, massive disaster strikes, environmental pollution, and others. In relation to these, the group of actions can be defined as security measures of a state and its organs, namely institutions and security services.

Security measures are activities and actions undertaken by state bodies to accomplish the protection of the stated social values. All security measures can be divided into general and specific, respectively special. General security measures are those undertaken by state bodies, while in the armed forces the commands and staffs, which create appropriate conditions for the effective protection of assets and social values, and the commitment of all entities of society or collective in carrying out obligations in the field of security. The insurance measure is realized with the approval of the legal acts and other general acts regulating this matter and the exercise of the duties and tasks that are defined in a normative manner. This means consistent respect of actions, regime, discipline and order in relation to protected values. Specific measures or special security, are applied by security services which, by serving with their specific methods, measures, actions and tools, detect, determine, fight, interrupt and follow the activity of the bearers of

threatening activities, thereby contributing to the protection of values and certain assets of persons, groups and society.

BIBLIOGRAFIA

- ✚ Alfredson, Gundumur et. Al. 1999. The Universal Declaration of Human Rights. Oslo: Scandinavian University Press.
- ✚ Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi „Sistemet e sigurisë-sisteme security” „Furkan-ISM “ Shkup, 2016
- ✚ Alston, Philip ed. 1999. The EU and Human Rights. Oxford: Oxford University Press.
- ✚ Alston, Philip and James Crawford eds. 2000. The Future of UN Human Rights Treaty Monitoring. Cambridge: Cambridge University Press.
- ✚ Bashkim Dr. Selmani “*Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi ndërkombëtar*” Botues: Universiteti parë privat „FON”- Shkup, 2008.
- ✚ Afrim Dr. Osmani “Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime” Shkup, 2010.
- ✚ Andreopoulos, George J. and Richard Pierre Claude. 1997. Human Rights Education for Twenty-First Century. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
- ✚ An-Na’im, Abdullahi Ahmed ed. 1992. Human Rights Cross-cultural Perspectives, A Quest for Consensus. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
- ✚ Asia-Europe Foundation ASEF. 2000. The Third Informal ASEM Seminar on Human Rights. Singapore.
- ✚ Baefsky, Anne F. 2002. How to Complain to the UN Human Rights Treaty System. Transnational Publishers.
- ✚ Bankie, B.F., Marias and J. T. Namiseb *comp.* 1998. Towards Creating a Sustainable Culture of Human Rights: the Southern African human rights reader. Windhoek: Macmillan.
- ✚ Baxi, Upendra. 1994. Inhuman Wrong and Human Rights: Unconventional Essays. Delhi: Har-Anand Publications.
- ✚ Baxi, Upendra. 2002. The Future of Human Rights. Oxford University Press.

✚ Benedek, Wolfgang ed. 1999. *Human Rights in Bosnia and Herzegovina, Theory and Practice*. The Hague: Martinus Nijoff Publishers.

✚ Benedek, Wolfgang and Alice Yotopoulos-Marangopoulos eds. 2003. *Anti-Terrorist Measures and Human Rights*, Kulwer Law International upcoming.

✚ Benedek, Wolfgang, Esther M. Kissaakye and Gerd Oberleitner. 2002. *The Human Rights of Women: International Instruments and African experiences*. London: Zed Books.

✚ Bjekovic, Sinisa, Vedrana Spahic-Vrkas and Nebojsa Vucinic eds. 2003. *Human Rights for Non-Lawyers*. Sarajevo: DD Stamparija Svjetlost- Fonica.